



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:222762
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05517944

C.nr.903/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.H me adresë në rrugën “G.G”, numër 12, nga të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fatmir Ademaj – avokat nga Peja kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në rrugën “Eduard Lir”, numër 173, në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensim i dëmit nga autopërgjegjësia, jashtë seancës gjyqësore, me datë 28.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit R.H me adresë në rrugën “G.G”, numër 12, e parashtruar në këtë gjykatë me datën 19.10.2023 kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Prisig” me seli në Prishtinë, sipas objektit të kontestit, kompensim i dëmit nga autopërgjegjësia.

A r s y e t i m

Paditësi R.H përmes të autorizuarit, me datën 19.10.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Prisig” me seli në Prishtinë, sipas objektit të kontestit kompensim i dëmit nga autopërgjegjësia.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit - avokati Fatmir Ademaj, me datë 02.03.2024, ka dorëzuar në këtë gjykatë parashtrësën për tërheqjen e padisë në këtë çështje juridike – kontestimore, duke e njoftuar gjykatën se paditësi nuk ka interes të mëtutjeshëm për vazhdimin e kësaj procedure, pasi që, i njëjti me të paditurën për këtë çështje kanë marrëveshje jashtëgjyqësore.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurën kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, e cila parashihet që: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*.

Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261, paragrafi 3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep*

aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”.

Andaj, në kuptim të lartëcekurave e në mbështetje të dispozitave nga neni 261 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i përgjithshëm- Divizioni për Çështje Civile
C.nr.903/23, datë 28.03.2024

Gjyqtarja
Pajtesë Boshnjaku

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.